



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri:** KSC-BC-2020-04

**Vendosi:** Kryetarja e Dhomave të Specializuara  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 14 shkurt 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Konfidencial

---

## Vendim për caktimin e gjykatësit të procedurës paraprake

---

**Gjykatësit të procedurës paraprake:**

Gjykatës Nikola Giju

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**

Xhek Smith

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara ("Kryetarja"), duke vepruar në bazë të neneve 32(3), 33(1)(a) dhe 38(4) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji"), rregullave 85(1) dhe 86(1) dhe (2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja") dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë ("Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve"), me anë të këtij vendimi cakton një gjykatës për kryerjen e funksioneve të gjykatësit të procedurës paraprake.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 14 shkurt 2020, Prokurori i Specializuar njoftoi Kryetaren në përputhje me rregullën 86(1) të Rregullores për nisjen e procedurave sipas nenit 38(4) të Ligjit dhe rregullës 86(2) të Rregullores dhe bëri kërkesë për caktimin e gjykatësit të procedurës paraprake në përputhje me nenin 33(1)(a) të Ligjit.

## II. CAKTIMI

2. Kryetarja cakton gjykatës të procedurës paraprake duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, në veçanti përvojën dhe kompetencën përkatëse si edhe disponueshmërinë në këtë moment.

## III. KLASIFIKIMI

3. Njoftimi është parashtruar konfidencialisht dhe ky vendim do të ketë të njëjtin klasifikim në përputhje me rregullën 82(4) të Rregullores, deri kur të riklasifikohet sipas rregullës 3(4) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve.

**PËR KËTO ARSYE, KRYETARJA ÇAKTON**

**Gjykatësin Nikola Giju**

si gjykatës të procedurës paraprake në këtë çështje.

          /nënshkrim/          

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,**

**Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E premte, 14 shkurt 2020  
Në Hagë,  
Holandë